



SUPLEMENTI "SHËNDETI"

► Faqe 13-17

■ SHËNDETI MENDOR, LIGJI I RI ME PROBLEME  
Lihen në harresë gratë e dhunuara dhe të ngjuarit  
■ Ç'DUHET TË BËNI PARA SHTATZANISË  
Këshillat: Jo duhan dhe alkool. Ushqehu shëndetshëm



Forumi me deputetët  
Hamshorët e Kukësit,  
Braçe: Meta mbro Beratin!

► Faqe 6

# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30 SHQIPTARJA.com + Suplementi "SHËNDETI"

VITI II - NR. 301 E enjte, 20-12-2012

Pëjetoni shpejtësinë



## RAPORTI AMERIKAN/ Si u arratisën nga vendi paratë e shqiptarëve NA VODHEN 1 MILIARD EURO

### Në 5 vjet u pastruan para, ja përfituesit

"Eksportimi" i parave nga Shqipëria drejt "parajsave fiskale" zbulohet nga dokumenta të BB dhe të FMN; më 2008 evazoni më i madh. Llalla: Zyrtarët fshehën pasuritë

#### VENDIMI I QEVERISE

**Berisha jep "gjysmagjelin" e fundvitit për pensionistët**

Shpërblimi 2 mijë lekë, para zgjedhjeve

#### Lajmi

Nga Shqipëria janë "arratisur" 1 miliard euro në 5 vjet. Këto fonde të vjedhura do të kishin sjellë paga, pensione e shpërblime më të mëdha, ndërkohë që shqiptarët duhet të kënaqen me një "çerek gjeli" në fundviti

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Global Financial Integrity (GFI) ka publikuar dje një raport mbi transferimin e paligjshëm të parave në vendet me ekonomi emergjente... ► vijon në faqe 2-5



BLOG/ LIVE FROM LIVE ► Faqe 22



TURPI DHE SHËNDETI

NGA ANJEZA SHATKU

POGRADEC ► Faqe 11



Gjendet i vdekur në kanal, vrasësi: Më pa me inat

#### Koment



NGA AFRIM KRASNQI

Hendeku ynë me perëndimin

Një komision parlamentar amerikan hetoi për më shumë se dy muaj lidhur me sulmin e shtatorit kundër ambasadës amerikane në Libi, ku mbeti i vrarë edhe ambasadori amerikan. Ambasadori Stephens është... ► vijon në faqe 22

#### Koment



NGA LAVDOSH FERRINI

Plani Çrregullues

Këshilltarët e Tiranës nuk mund të votojnë për miratimin e Planit Regullues të Tiranës në mbledhjen e rradhës. Ky është as më pak e as më shumë një plan i shkatërrimit të së ardhmes së Shqipërisë. Ato duar që mund të... ► vijon në faqe 23

#### KUJTIMET E ISH-PRESIDENTIT

## Moisiu: Debatet me Mehmet Shehun

"Puçi" në ushtri në 1974, mbledhja e 12 dhjetorit dhe kryqëzimi i gjeneralëve

KRITERET ► Faqe 5



Fondi i ekselencës për studentët, ja kush e përfiton

Mundem  
DEPOZITA E RE ME AFAT

• Interes deri në 7% në Lek

INTESA SANPAOLO BANK

Drejt të ardhmes me ju.

■ ■ ■ TIRANE

ALFRED MOISIU

A e shihni që Alfred Moisiu nuk është këtu në mbledhje, atij i kam dhënë urdhër të ndjekë... ► Faqe 18-19

**NERANXI**  
... gjithmonë një hap përpara...  
Ushqime aziatike dhe meksikane

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 7, Yrshok Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com



# Shkrimtari

■ ■ ■ TIRANE

SHEFQET DIBRANI

Më datën 6 dhe 8 dhjetor 2012, në qytetin e Dallasit, në Amerikë, përkatësisht në ambientet e Universitetit të Tek-sasit në Dallas (UTD), u mbajt ceremonia e diplomimit të rreth 1911 studentëve, të cilët i kanë përfunduar studimet e niveleve të ndryshme pranë këtij Universiteti. Nga Shkollat e Arteve dhe Shkencave Humane u diplomuan më PhD katër studentët: Dr. Dallie Bremer Clark, Dr. Anne Healy, Dr. Gjekë Marinaj dhe Dr. Jeffrey F. Pettineo. Ky i fundit, për arsye personale, nuk mori pjesë në këtë ceremoni. Ndonëse kjo ngjarje është e rëndësishme për qytetin e Dallasit dhe shoqërinë amerikane, për ne shqiptarët nuk do të kishte atë rëndësi që ka, sikur sivjet të mos laureohej me gradën akademike PhD edhe Gjekë Marinaj, shqiptarë nga Malësia e Madhe, emër publik, poet e përkthyes i njohur, si dhe një pedagog dhe studiues i zellshëm. Në ceremonitë festive, për ta nderuar dhe respektuar njeriun e tyre, kishin udhëtuar nga Tirana, midis tjerësh, edhe Tonin dhe Lindita Marinaj, të cilët bashkë me miqtë e tjerë, kudo i shoqëronte zonja e shtëpisë, bashkëshortja e Gjekës, Dusita Marinaj, e cila padyshim ka merita të mëdha për suksesin e burrit të saj, i cili pohon se "Dusita më ka dhënë një ndihmesë të jashtëzakonshme gjatë studimeve, sepse pa një jetë me dashuri të pastër dhe paqe të plotë në shtëpi është gati e pamundur të gjejsh sukses në jetën akademike". Që të mos zgjerohemi me detajet dhe anët teknike të ceremonisë në fjalë, këtë reportazh të shkurtër po e ilustrojmë me mendimet e personaliteteve akademike në UTD dhe Kolegjin ku ai ligjëron, për t'i lënë vend edhe një shënimi biografik.

Në këtë plan vlen për t'u cituar shënimi i vënë në librezën e ceremonisë së laureatëve të Doktoratës, së datës 6 dhjetor 2012, botuar nga Universiteti i Teksasit në Dallas, shënimi ky për Marinajn që është shkruar nga kandidati për çmimin Nobel në letërsi Prof. Frederick Turner i cili thotë: "Poetët e mirë janë të rrallë. Poetët e mirë që kanë edhe komandën e gjuhëve të jenë përkthyes të mirë janë edhe më të rrallë. Kur një njeri i tillë është dhe drejtë, edhe një hero nacional siç është Gjekë Marinaj për Shqipërinë - i cili mezi u shpëtoi armëve të regjimit komunist që kërkonin jetën e tij vetëm se kishte shkruar një poezi kritike kundër regjimit, një poezi që u kthye në britmën kolektive të demonstratave që i sollën lirinë vendit - ne kemi diçka edhe më të rrallë. Kur ky individ ka kompozuar si pjesë të disertacionit të tij një antologji shumë të rëndësishme, akoma të pabotuar, të poezisë gojore shqipe, dhe kur ai është i diplomuar nga universiteti ynë, ne duhet ta njohim



Dr. Frederik Turner dhe John Wiorowski duke i vënë kurorën akademike të gradës Profesor Dr. Gjekë Marinaj

## Realizimi i ëndrrës së Gjekë Marinaj

*U arratis në Amerikë 23 vjet më parë*



Shkrimtari Gjekë Marinaj

### F. Turner

"Kur ky individ ka kompozuar si pjesë të disertacionit të tij një antologji shumë të rëndësishme, akoma të pabotuar, të poezisë gojore shqipe, dhe kur ai është i diplomuar nga universiteti ynë, ne duhet ta njohim fatin tonë për ta laureuar sot atë!"

fatin tonë për ta laureuar sot atë!"

### REALIZIMI I ËNDRRËS

Profesoresha Charlotte Karam, kolege e punës në Kolegjin Riçland (Richland College), aty ku Gjekë Marinaj prej sa vitesh është mësimdhënës, deklaroi: "Si mike dhe

kolege e Gjekë Marinajt, e kam parë atë duke punuar dhe studiuar në të gjitha orët e ditës dhe natës për detyrimet e tij akademike dhe qëllimet letrare. Sot ai ka realizuar një nga ëndrrat e tij më të mëdha: fitimin e titullit Doktor i Filozofisë në Shkencat Humane. Jam e sigurt se ky "dia-

mant" Amerikan nga Shqipëria do e përdor kohën dhe talentin e tij për të arritur maja edhe më të larta!"

Ndërsa Gjekë Marinaj, me modestin e tij prej njeriu dhe intelektualit me këtë rast do të shtonte: "Këtë piketë të rëndësishme në jetën time ua dedikoj të gjithë mësuesve (duke filluar nga prindërit e mi) dhe profesorëve nga Shqipëria deri në Amerikë, të cilët gjatë kohës së studimeve, përmes dashurisë njerëzore, sakrificës personale dhe dedikimit profesional më kanë dhënë mbështetjen e duhur njerëzore dhe akademike, pa të cilën diplomimi im nuk do të kishte qenë i mundur".

### Arte pamore

## Kostandini e Odobashi në studion e hapur

Dëshira për të marrë impulse/ngacime nga artdashësit, nga kolegët dhe jo vetëm, mbi punimet e tyre më të fundit, i ka shtyrë dy artistet e talentuara Ledia Kostandini dhe Matilda Odobashi që të organizojnë diçka kaq intime siç është Open Studio, ku nisën të ekspozonin më 15 dhjetor dhe të vijonë sërish në fundjavë deri më 23 dhjetor. Ledia Kostandini thotë se "Unë zgjedh të



udhëtoj me instalacionin e parakrijuar në studio, drejt një destinacioni specifik. Realitetin e përdor si një skenografi dramatike mbi të cilën luhet një komedi. Ndërsa Matilda Odobashi rrefen se "Punimet, kryesisht krijimet e fundit, janë shpërshfaqje e anktheve, frikërave dhe ndjesisë klausrofobike që ambienti urban dhe marrëdhëniet njerëzore në këto ambiente, ngjallin tek vet njerëzit.

## Letërsi Ndahen çmimet kombëtare

Ndahen sot Çmimet Kombëtare të Letërsisë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kryetari i jurisë i këtij edicioni është shkrimtari Amik Kasoruh. Organizatorët pohojnë se do të ndahen 10 çmime për zhanre të ndryshme, përfshirë poezinë, prozë dhe përkthim, si dhe ndahet çmimi kombëtar për letërsi, të gjitha të emëtuara sipas personaliteteve të historisë letrare, si Gjergj Fishta, Fan Noli dhe përkthyesi Jusuf Vriani. Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të zhvillohet në orën 18.00 në Teatrin Kombëtar. Vitin e kaluar juria ia akordoi "Çmimin e madh të letërsisë" Sabri Hamitit me veprën "Poetika shqipe", ndërkohe që u ndanë edhe nëntë çmime të tjera.



Amik Kasoruh

## Poeteka Diskutimet multikultura e feminizmi

Edicioni i tetë i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë dhe Letërsisë "Poeteka", që e çeli siparin në datën 17 dhjetor në Qendën TEN, dje ka zhvilluar diskutimin rreth multikulturit & feminizmit me të ftuarit Albana Nexhipi, Edmond Tupja, Ema Andrea, Mimoza Hysa, Eljan Tanini, Lislana F. Demiraj, Elona Çulqi, Sabina Veizaj, etj. Përveç këtyre diskutimeve çdo mbrëmje, pjesë e formateve të Poeteka 2012 janë bërë dhe filma me metrazh të shkurtër të studentëve të Universitetit të Arteve Tiranë. Festivali Ndërkombëtar i Poezisë dhe Letërsisë është një takim i përvitshëm i artistëve të arteve të fjalës së shkruar, shkrimtarëve, kritikëve të artit, eseteistëve, përkthyesve, botuesve dhe i artistëve të tjerë.



Arjan Leka